

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**  
**Formulari i Njoftimit të Ofertuesit të Përzgjedhur**

Data: 31.10.2017

Për: “Gjoka Konstruksion” sh.a. Njësia 5, Rruga “Dora D’Istria”, hyrja 1, 2. Tiranë – Shqipëri  
Përshkrim i Shkurtër i Procedurës së Konkurrimit të Koncesionit/PPP:

“Dhënie me Koncesion/PPP i ”Përmirësimit, Ndërtimit, Operimit dhe Mirëmbajtjes së Rrugës së Arbrit”.

Ne ju informojmë se, Ofertuesit e Mundshëm të mëposhtëm kanë qenë pjesëmarrës në tender duke ofruar përkatësisht:

1. Operatori Ekonomik “Adem Pojani” Vlera –; Nuk ka paraqitur ofertë financiare;
2. Operatori Ekonomik “Alb-Star” sh.p.k. Vlera –; Nuk ka paraqitur ofertë financiare;
3. “Gjoka Konstruksion” sh.a; Vlera: 33,600,000,000 lekë (tridhjetë e tre miliard e gjashtëqind milionë lekë).

Janë Skualifikuar Ofertuesit e Mundshëm të mëposhtëm:

1. Operatori Ekonomik “Adem Pojani”;
2. Operatori Ekonomik “Alb-Star”sh.p.k.;

Arsyet e skualifikimit: Operatori Ekonomik “Adem Pojani” nuk plotëson asnjë nga kriteret e kualifikimit, si dhe nuk ka paraqitur ofertë financiare;

Arsyet e skualifikimit: Operatori Ekonomik “Alb-Star”sh.p.k. nuk plotëson kriteret e kualifikimit, si dhe nuk ka paraqitur ofertë financiare;

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e Republikës së Shqipërisë njofton shoqërinë “Gjoka Konstruksion” sh.a. Njësia 5, Rruga “Dora D’Istria”, hyrja 1, 2. Tiranë – Shqipëri se Oferta e paraqitur në 02.10.2017 në lidhje me Projektin “Dhënie me Koncesion/PPP i ”Përmirësimit, Ndërtimit, Operimit dhe Mirëmbajtjes së Rrugës së Arbrit”, është pranuar.

Brenda 30 ditëve Ofertuesit “Gjoka Konstruksion” sh.a i kërkohet të paraqesë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë së Republikës së Shqipërisë:

- Një kopje të nënshkruar të Njoftimit të Ofertuesit të Përzgjedhur.
- Sigurimin e Kontratës në përputhje me Klauzolat e parashikuara në Kontratën e Koncesionit.
- Pagesat e Autoritetit Kontraktues dhe ATRAKO

Në rast se Ofertuesi nuk dëshiron të nënshkruajë Kontratën e Koncesionit, ju do të njoftoni Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë së Republikës së Shqipërisë me shkrim. Në këtë rast Sigurimi i Ofertës do të mbahet nga Autoriteti Kontraktues.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datën 20.10.2017

Ankesa: Nuk ka patur

opencorporatesAlbania  
The Open Database Of The Albanian Corporates